

## BIOGRAFIA E AUTORIT

Destan Gashi u lind më 1952 në Zoqishtë (Rahovec). Në vitin 1975, diplomoi në Shkollën e Artit në Pejë. Në vitin 1978, përfundoi studimet e pikturës në Akademinë e Arteve të Bukura në Bruksel (Belgjikë) te profesoresha Van-sevenbergen, ndërsa që në vitin 1985 kreu studimet për skulpturë në të njëjtën Akademi në Bruksel, te profesori Martin Guyaux. Gjatë kohës së studimeve, për punën dhe përkushtimin e tij në skulpturë, ky autor ka marrë disa çmime e dekorata nga qyteti i Brukselit, si:

- Prix d' Excellence de la Ville de Bruxelles
- Prix de Doutreron de Try
- Medaille der Stadt Brüssel

Nga viti 1985 e gjer tash, Destan Gashi ka realizuar një mori ekspozitash kryesisht në Austri, por edhe në shtete të tjera. Shumë vepra të tij u përkasin tashmë koleksioneve private të njerëzve në Belgjikë, Holandë, Itali, Austri, Spanjë, Gjermani, SHBA. Destan Gashi, nga viti 1987, jeton dhe krijon në Vjenë të Austrisë si skulptor i pavarur. Ai është ndër të rrallët skulptorë bashkëkohorë që zotëron mjeshhtërinë e skulptorit në kuptimin e mirëfillt të fjalës, pra të gurgdhendësit.


Kjo ekspozitë e skulpturave që prezantohet në Bibliotekën Kombëtare "Pjetër Bogdani", është ekspozita e tij e parë e mbajtur në Kosovë.

## EKSPOZITAT

- Muzeu «Alice et David van Buuren», Bruksel, 1985
- Galeri Station 3, Vjenë, 1992
- Madeni Romak, St. Margarethen, 1994
- Galeri 22, Vjenë, 1995
- Galeri Zu ebener Erde und im Ersten Stock, Korneuburg, 1994, 1996, 1998, 2001, 2004, 2006, 2007
- Galeri Am Stubentor, Vjenë, 1995, 1996, 1999
- Galeri Plos, Sooss, 1997, 1998, 2000, 2002, 2003, 2004, 2005, 2006, 2007, 2008
- AAI Galeri, Vjenë, 2000
- Galeri Gruber, Krems, 2000
- Galeri Ezzo, Vjenë, 2004
- Pallati Concordia, Vjenë, 2005



Shikuesja - 30x20x60 cm  
Mermer nga Wachau - 2014



- BAWAG, Vjenë, 2006
- Raiffeisenbank, Korneuburg, 2007
- Kunsthaus Rust, Rust, 2008, 2009, 2012
- Kopshti Botanik, Graz, 2009, 2011
- Pallati Gabelhofen, Fohnsdorf, 2009
- Brotway Vjenë, 2010
- Galerie Altesse, Liechtenstein, 2011
- Galerie Gasser Haus, Vjenë, 2012
- Salla e Kulturës, Himberg, 2013
- Galeri Artefakt, Pallati Ferstel, Vjenë, 2008, 2013
- Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani", Prishtinë, 2014

## SHPËRBLIMET

- Prix d' Excellence de la Ville de Bruxelles
- Prix de Doutreron de Try
- Medaille der Stadt Brüssel

## ARTI NË HAPËSIRËN PUBLIKE

- Dona Brabantia, Bruksel, Belgjikë, 1985
- Dy vajzat, Korneuburg, Austri, 1997
- Peshorja, Sooss, Austri, 2005
- Zana e detit, St. Margarethen, Austri, 2009

## SIMPOZIUM

- 2012, Simpoziumi i Danubit në Pöchlarn



Zhytësja - 82x25x20 -  
Mermer nga Wachau (Austri)  
Basament mermer nga Sölk - 2008

# DESTAN GASHI



Gruaja e Hasit - 60x30x65cm - Mermer nga Gummern (Austri) - 2010



Vajza ulur - 17x25x36cm, 2011 - Mermer nga Karrara - 2011



Kali i Doruntinës - 55x25x33cm - Serpentinë e egër - 2012



Puthje - 23x39x25cm - Mermeri nga Sölk (Austri) - 2011



Pasion - 57x65x65cm - Mermer nga Karrara (Itali) - 2010



Bretkosa - 20x27x20cm - Mermer nga Arlberg (Austri) - 2013

# EKSPOZITË PERSONALE



Legjenda e Rozafës - 30x26x60cm - Mermer nga Karrara - 2013



LEGJENDA E ROZAFËS DHE HISTORI  
TË TJERA NË GUR  
(20 skulptura prej mermeri të skulptorit shqiptar Destan Gashi)

PRISHTINË  
2014

Botues:  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës  
"Pjetër Bogdani"

U.d. e drejtorit:  
Ramize Bajraktari

Dizajni  
Hekuran Rexhepi

© 2014. BKUK

Prishtinë  
2014

# DESTAN GASHI

## LEGJENDA E ROZAFËS DHE HISTORI TË TJERA NË GUR

*(20 skulptura prej mermeri të skulptorit shqiptar Destan Gashi)*

*Legjenda e Rozafës dhe histori të tjera në gur, është titulluar ekspozita e cila ishte shpalosur para publikut vjenez në pranverën e vitit 2013 dhe kjo ekspozitë, po me këtë emër, do të prezantohet edhe në Prishtinë, më 16 prill të vitit 2014, në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani". Është kjo një histori e legjendave dhe e miteve më të njohura shqiptare e gdhendur në gurë nga skulptori Destan Gashi. Jehona mediale që bëri ekspozita e këtij skulptori në Vjenë, aty ku u prezantua, por edhe në Kosovë e Shqipëri, ishte e jashtëzakonshme. Pothuaj nuk kishte gazetë që nuk shkroi për ekspozitën e kosovarit Destan Gashi që prezantoi në Vjenë. Ky ishte një motivim prej të cilit lindi edhe ideja që të punohet në përgatitje të kësaj ekspozite edhe në Kosovë dhe Shqipëri. Kjo ëndërr e autorit kosovar, që jeton aq fuqishëm në thellësinë e mitit e të legjendave me burim nacional, tashmë u bë realitet. Vepra e Destan Gashit po prezantohet në Prishtinë.*



Janë këto punime prekëse në skulpturë të këtij autori që të rrembejnë me shenjat, lakesat, thellësitë e ngritjet, që përtojnë një frymë e ndjenjë kujtese për botën e gjallë e shprehëse të legjendave e miteve shqiptare, por edhe mbi përsosmërinë e harmoninë e trupave që tërheqin vëmendjen me masën dhe simetrinë, duke i dhënë kuptime të ndryshme bukurisë.

Gurët na tregojnë histori shqiptare, si ajo e legjendës së Rozafës, Doruntinës dhe hasjaneve, grave krenare të Malësisë së Hasit të fshatrave pranë Drinit të Bardhë, të ndërgjegjshme për traditat e tyre.

Legjenda e Rozafës, është një skulpturë me mermer nga Karrara që mishëron të porsalindurin në gjirin e Rozafës. Sipas legjendës, gruaja e re Rozafa u muros e gjallë në muret e kështjellës së Shkodrës në Shqipërinë e Veriut, meqë ngrehina rrezohej vazhdimisht gjatë ndërtimit, prandaj duhej të flijohej një njeri. Rozafa trimë e pranoi fatin e saj, por dëshira e saj e fundit ishte që të mund t'i jepte gji të sapolindurit edhe më pas, që edhe iu pranua si amanet. Në mur u la një e çarë, aq e madhe sa t'i jepte sisë foshnjës. Muret e ndërtesës tani qëndruan, kështjella mund të ndërtohej.

Kali i Doruntinës, (që vjen, përveç si një motivim nga legjenda, edhe nga fuqia që i jep romani i Ismail Kadaresë "Kush e solli Doruntinën") është skulpturë në të cilën është përdorur materiali serpentinë e egër me ngjyrë të gjelbër në të zeze për të bërë kokën e kalit, fuqia e imazhit të së cilës, po si në legjendë, thua të jetë fantazmë apo realitet?! Sipas legjendës një vajzë shqiptare me emrin Doruntina e martuan në vendin e largët Boemi. Njëri prej vëllezërve i premtoi nënës që do ta sillte motrën nga dheu i largët në shtëpi sa herë që njëra prej të dyjave do të dëshironte. Atë që askush nuk mund ta merrte me mend, ishte fakti që pak më vonë të gjithë burrat e familjes u vranë në një luftë. Pas kësaj, një natë Doruntina, që nuk dinte asgjë për fatkeqësinë, trokiti në derën e shtëpisë prindërore. Nënës iu duk si një fantazmë, ngase Doruntina i tregoi që atë e kishte sjellë për një natë prej Boemisë në shtëpi i vëllai me kalë. Por, djaloshi kishte kohë që kishte vdekur dhe as prej kalit nuk shihet e nuk u gjet asnjë gjurmë. Një legjendë kjo në të cilën bëhet fjalë për besën, fjalën e nderit të shqiptarët, të cilën vëllai e mban bile edhe pas vdekjes, pasi ai kishte premtuar se do ta sillte motrën në shtëpi.

Gruaja nga Hasit është skulpturë me mermer nga Gummern. Kjo skulpturë është shprehje e fuqisë së ruajtjes së traditës së gruas hasjane. Hasjanet, gratë e Malësisë së Hasit, në verilindje të Shqipërisë dhe në veriperëndim të Republikës së Kosovës, ruajnë ende doket dhe traditat e vjetra. Krahinën e njeh menjëherë prej veshjes hasjane, ashtu siç e njeh shpirtin e saj edhe në skulpturën e Destan Gashit.

Një fund me vija, i endur me dorë, që mbërthehet mbrapa te vitet me një dërrasë të hollë dhe që e bën të duket fundin nga prapa si një drejtëkëndësh. Kjo është karakteristika kryesore e kostumit të grave hasjane, që jepet me një shprehje të figurshme plot ekspresivitet në veprën e këtij autori. Edhe në veprat e tjera skulpturale, duke i qëndruar besnik traditës së skulpturës në gur, Destan Gashi i kushtohet pothuaj me obsesion temës së aktit femëror.


Mund të shihni edhe mjaft skulptura prej ciklit "Kokë vajzash" që janë krijuar vitet e fundit.

Çdo skulpturë përfaqëson një individualitet të qartë që bazohet ndër të tjera edhe në vetitë e vetë mermerit. Studime të gjata mbi natyrën dhe anatominë e lejojnë sot autorin që t'i skalitë figurat direkt në gur pa pasur nevojë për model dhe këtë e bën me lehtësi, siguri dhe fuqi krijimi, duke i dhënë veprës një perceptim estetik të veçantë.

**Teksti: Barbara Gashi, piktoe akademike**



**Dy Vajza** - 25x17x31cm - Mermeri nga Vorarlberg - 2011



**Kengë për pavarinë** - 40x32x40cm - Mermer nga Austria - 2012



**Komet** - 96x35x86 cm - Mermer nga Karrara (Itali) - 2013



**Nëna me fëmijë** - 60x50x50cm - Mermer nga Gummern (Austri) - 2010



**Adela** - 45x35x28cm - Mermer nga Wachau (Austri) - 2013



**Gjarpër** - 43x26x31cm - Serpentin i egër - 2014



**Afrikane** - 64x27x33 cm - Mermer nga Salzburgu - 2007



**Kërmill** - 54x34x30cm - Mermeri nga Sölk (Austri) - 2009



**Engjell duke kënduar** - 20x30x42cm - Mermer nga Austria - 2012



**Ngrohja në diell** - 16x11x28cm - Mermer nga Karrara (Itali) - 2012



**Dy vajza duke u larë në Ksamil** - 80x38x30cm - Mermer (Austri) - 2013